



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2019:152360

Datë: 25.11.2023

Numri i dokumentit: 04973244

P.nr.356/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC, Departamenti i Përgjithshëm-Dvizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Shefqet Baleci, me pjesëmarrjen e zyrtarës ligjore Shpresona Gashi, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.J nga ..., Komuna e Drenasit, i akuzuar për veprë penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.2352/2019, datë.03.07.2019, e pas ricilësimit të bërë ligjor nga gjykata për veprë penale Vjedhja e shërbimeve, të parashikuar nga neni 314 par.6. lidhur me par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)-Kodi i ri Nr.06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 14 Janar 2019, Prishtinë, i cili ka hyrë në fuqi me datën.14 Prill 2019, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, për dhënjën e urdhërit ndëshkimor pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësorë, PP.II.nr.2352/2019, datë.03.07.2019, me datë.**24.11.2023**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET KËRKESA E PROKURORISË THEMELORE-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM në Prishtinë PP.II.nr. 2352/2019, datë.03.07.2019, dhe gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I AKUZUARI: A.J, i biri i ..., i lindur me dt...., me vendbanim në ..., Komuna e Drenasit, me numër personal të letërnjoftimit ..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, i gjendjes të mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: me datën 30.07.2018, në shtëpinë e tij në ..., Komuna e Drenasit, i akuzuari me qellim të përfitimit të dobisë pasurore, në mënyrë të kundërligjshme kishte marrë energjinë elektrike pa lejen dhe autorizimin e furnizuesit të autorizuar në këtë rast të KEDS-it, në atë

mënyrë që, kishte bërë manipulime-ngacmime nga jashtë në njehsorin elektrik me nr.64101380, ku të dëmtuarës K ... në Prishtinë i kishte shkaktuar dëm material në vlerë prej 108.60 €,-

-me këtë ka kryer veprë penale Vjedhja e shërbimeve, të parashikuar nga neni 314 par.6. lidhur me par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Andaj gjykata në bazë të nenit 4,7,17,21,38,43,59,61,69 dhe nenit 314 par.6. lidhur me par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe neneve 495,359,3ë,364 dhe 449 par.2. nënpar.2.6. dhe par.3. të Kodit të Procedurës Penale (KPP), i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarit A.J në shumë prej 100 (njëqind) €, të cilin detyrohet të e paguaj në afat prej 15 ditë, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari A.J në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata mund të e zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burg në kohëzgjatje prej 5 (pesë) ditë.

Kur dënim me burgim zëvendësohet me dënimin me gjobë, njëzetë (20) € gjobë llogaritet barabartë me një ditë burgim, kjo mundësi e zëvendësimit është e bazuar në dispozitën e nenit 43 par.3. të KPRK-së.

Nëse i akuzuari në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën në tërësi, gjykata do të zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim, siq parashihet në paragrafin 3 të nenit 43 të KPRK-së. E nëse personi i dënuar e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimin ndërpritet.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mundet, me pëlqimin e të akuzuarit, në vend të shqiptimit të dënimin me burgim, të e zëvendësojë dënimin me gjobë me urdhër për punë në dobi të përgjithshme. Urdhri për punë të përgjithshme llogaritet ashtu që tetë (8) orë të punës në dobi të përgjithshme llogariten me njëzetë (20) € gjobë, kjo mundësi e tillë e zëvendësimit është e bazuar në dispozitën e nenit 43 par.5. të KPRK-së.

Të akuzuarit A.J i shqiptohet **DËNIMI PLOTËSUES-Urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit**, ashtu që urdhërohet i akuzuari A.J që të dëmtuares K ... në Prishtinë, të ia bëjë dëmshpërblimin në vlerë prej **108.60 (njëqind e tetë € e gjashtëdhjetë Cent) €**, këtë në afat prej 15 ditë, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kanosjen e përmbarimit me dhunë.

Detyrohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësorë të paguajë shumën prej **20 €**, këtë në afat prej 15 ditë, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kanosjen e përmbarimit me dhunë.

Detyrohet i akuzuari që për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj taksën në shumë prej **20 €**, këtë në afat prej 15 ditë, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kanosjen e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Deparatamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.2352/2019, datë.03.07.2019, ka akuzuar të akuzuarin për veprë penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1.të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), poashtu ka ushtruar kërkesën për dhënjën e urdhërit ndëshkimor dënim me gjobë pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor PP.II.nr.2352/2019, datë.03.07.2019, me arsyetim se ka prova të

mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që e vërtetojnë kryerjen e kësaj veprë penale nga i akuzuari.

Sipas nenit 3 par.1. të KPRK-së-Kodi i ri, përcaktohet se: “ndaj kryesit zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale”, ku për veprën penale Vjedhja e shërbimeve komunale, të parashikuar nga neni 320 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)-Kodi i vjetër Nr.04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës, është i paraparë dënimi me gjobë dhe me burgë deri në 3 (tre) vite, gjykata duke u bazuar në nenin 3. par.2. të KPRK-së-Kodi i Ri, përcaktohet se: ”në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është me i favorshëm”, kjo gjykatë ka bërë ricilësimin ligjor të veprës penale Vjedhja e shërbimeve komunale, të parashikuar nga neni 320 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)-Kodi i vjetër Nr.04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës, në veprën penale Vjedhja e shërbimeve, të parashikuar nga neni 314 par.6. lidhur me par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)-Kodi i ri Nr.06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 14 Janar 2019, Prishtinë, i cili ka hyrë në fuqi me datën.14 Prill 2019, ku është i paraparë dënimi me gjobë ose me burgë deri në 3 (tre) vite, këtë duke u bazuar në nenin 3ë par.2. të KPP-së, ku thuhet se: “gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës” pasi që Kodi Penal i Republikës së Kosovës (KPRK)- Kodi i ri Nr.06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 14 Janar 2019, Prishtinë, i cili ka hyrë në fuqi me datën.14 Prill 2019, për këtë veprë penale është më i favorshëm për kryesin.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënjën e urdhërit ndëshkëmor, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për pranueshmërinë për dhënjën e urdhërit ndëshkëmor pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, dënim me gjobë, në vështrim të nenit 495 par.1. të KPP-së.

Gjykata duke i vlerësuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë: kallëzimin penal me nr.të rastit CMS-K/DPR-88, dt.26.04.2019, i të dëmtuarës, procesverbali me nr.0795466, dt.30.07.2018, i të dëmtuarës, procesverbali me nr.0936474, dt.30.07.2018, i të dëmtuarës, fotot e njehsorit elektrik-tre foto, kalkulimi i RH me me ID të rastit 207877, dt.19.10.2018 dhe fatura DPRHP1825634, dt.19.10.2018, konstaton se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i akuzuari ka kryer veprë penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6. lidhur me par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), për të cilën veprë penale është i paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në 3 (tre) vite, ashtu që gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe e dënoi me gjobë në shumë prej 100 € (njëqind) €, (nëse i akuzuari në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burg në kohëzgjatje prej 5 (pesë) ditë, kur dënim me burgim zëvendësohet me dënimin me gjobë, njëzetë (20) € gjobë llogaritet barabartë me një ditë burgim, kjo mundësi e zëvendësimit është e bazuar në dispozitën e nenit 43 par.3. të KPRK-së), Me bindjen se dënimi me gjobë është në përputhshmeri të plotë me shkallën e rrezikshmerisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësin penale të të akuzuarit, dhe se i njëjti dënim do të ndikoi që të parandaloi të akuzuarin nga kryerja e veprave penale në të ardhmën dhe të bëjë rehabilitimin e tij si dhe të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e të dëmtuarës për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 38 të KPRK-së.

Vendimin që të akuzuarit A.J të i shqiptohet dënimi plotësues-Urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit, ashtu që urdhërohet i akuzuari A.J që të dëmtuarës K ... në Prishtinë të ia bëjë dëmshpërblimin në vlerë prej 108.60 (njqind e tetë € e gjashtëdhjetë Cent) €, këtë në afat prej 15 ditë, nga dita e plotëfuqishmerisë së këtij aktgjykimi, e nën kanosjen e përmbarrimit me

dhunë, gjykata e bazoi në nenin 59 të KPRK-së (ku përcaktohet se dënimi plotësues mund të shqiptohet së bashku me dënimin kryesor ose alternativë), e lidhur me nenin 61 par.1. të KPRK-së (ku përcaktohet se kur gjykata dënon personin i cili është shpallur fajtor për çfarëdo vepre penale që përfshin vjedhjen, humbjen, dëmtimin apo shkatërrimin e pasurisë, gjykata do të urdhëroi kryesin që të bëjë dëmshpërblimin e viktimës së veprës penale).

Vendimin që i akuzuari të paguaj në emër të paushallit gjyqësorë shumë prej 20 €, gjykata e bazoi në nenin 449 par.2.6. dhe par.3. të KPP-së, duke pasurë parasysh zgjatjen dhe ndërlikueshmerinë e procedurës dhe gjendjen financiare të akuzuarit.

Vendimin që të detyrohet i akuzuari që për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj taksën në shumë prej 20 €, gjykata e bazoi në nenin 36 par.3. nënpar.3.1. të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, ku është paraparë se gjyqtarët me rastin e shqiptimit të sanksioneve penale për veprat penale të përcaktuar në nën paragrafi 3.1. të këtij paragrafi caktojnë edhe taksat për kompensimin e viktimave si në vijim: për veprat penale që gjykohen nga Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në shumë prej njëzet (20 €).

Nga e lartëtheksuara është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
P.nr.356/2023, datë:24.11.2023

Zyrtarja Ligjore
Shpresona Gashi

G j y q t a r i
Shefqet Baleci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 496 par.2. të KPP-së. i pandehuri mund të ushtrojë kundërshtim në afat prej 8 ditë, nga dita e pranimit dhe kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate. Nëse kundërshtimi nuk hudhet për shkaqe të arsyeshme, atëherë gjykata do të caktoj mbajtjen e shqyrtimit gjyqësorë sipas aktakuzës së ushtruar. Nëse nuk paraqitet kundërshtimi apo paraqitet pas afatit, urdhëri ndëshkimorë merrë formen e prerë dhe ekzekutohet.